



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.133, datë 24.12.2020

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 10 TË VKB NR.74, DATË 24.07.2020
DHE ANEKSIT 4 TË VKB NR. 77, DATË 10.08.2020

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raporteve të Komisionit të Posaçëm, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 10 të VKB nr. 74, datë 24.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 2, me numër aplikimi 53850, sipas relacionit bashkëngjitur.

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 4 të VKB nr. 77, datë 10.08.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 2, 4, 5, 6, Sukth, Katund 1 Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 9, me numër aplikimi 42824, sipas relacionit bashkëngjitur.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së BPSHV dhe Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____, 2020

RELACION

KOMISIONI I POSAÇËM

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 10 TË VKB NR.74 DATË 24.07.2020
DHE ANEKSIT 4 TË VKB NR 77 DATË 10.08.2020**

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, si dhe Komisioni i Posaçëm , i ngritur me Urdhërin nr.164, datë 26.05.2020 i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020 do të vlerësojë kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve të aplikuesve për banesat individuale me nivel dëmi DS4-DS5 në Bashkinë Durrës”,

Ju paraqesim relacionin si më poshtë:

Zyra e Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes i ngritur me urdhërin nr. 108, datë 12.03.2020 të Zëvendëskryetarit të Bashkisë, pasi ka shqyrtuar dosjet i është drejtuar Komisionit të Posaçëm me raportin nr. 9565/6 prot. datë 23.06.2020 dhe raportin nr. 9565/11 prot. datë 29.07.2020 për subjektet që kualifikohen në programin e granteve të rindërtimit dhe projekteve model. Në bazë të raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Komisioni i Posaçëm i është drejtuar me raportin nr. 9565/6 datë 23.06.2020 dhe raportin nr.9565/15 datë 29.7.2020 Këshillit Bashkiak për miratimin subjekteve përfituese.

Pas riveifikimit të dokumentacionit, Zyra e Posaçme e Rindërtimit i është drejtuar Komisionit të Posaçëm me relacionin nr. 9565/43 datë 21.10.2020, për ndryshimin e raporteve të mësipërme që Komisioni i Posaçëm i është drejtuar Këshillit Bashkiak dhe ndryshimit të vendimit nr.74 datë 24.07.2020, për heqjen e subjektit përfitues me numër rendor 2, nr aplikimi 53850 në Aneksin nr.10 dhe me relacionin nr. 9565/56 datë 23.12.2020, për ndryshimin e vendimit nr.77 datë 10.08.2020, për të hequr subjektin përfitues me numër rendor 9, nr aplikimi 42824 në Aneksin nr.4, pasi nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qënë përfitues nga procesi i rindërtimit.

Bazuar në relacionet e dërguara nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Komisioni i Posaçëm kërkon ndryshimin e vendimit nr.74 datë 24.07.2020, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 2, nr aplikimi 53850 në Aneksin nr.10 dhe ndryshimin e vendimit nr.77 datë 10.08.2020, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 9, nr aplikimi 42824 në Aneksin nr.4

Për sa mësipër kërkojmë:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 10 të VKB nr. 74, datë 24.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 2, me numër aplikimi 53850, sipas relacionit bashkëngjitur.
2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 4 të VKB nr. 77, datë 10.08.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 2, 4, 5, 6, Sukth, Katund i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr subjektin përfitues me numër rendor 9, me numër aplikimi 42824, sipas relacionit bashkëngjitur.

Kryetar i komisionit të posaçëm: Florian Tahiri

Anëtar :Ermal Lufo

Audi Cerri,

Diana Mandia,

Klara Agasi,

Edvin Hysi,

Afroviti Manthjo,

Ei jon Meka

Rrapo Osmani


ANEKSI 10. SUBJEKTET PËR FITUESE TE GRANTIT TE RIKONSTRUKSIONIT NJESIA ADMINISTRATIVE SUKTH

NR	NUMRI APLIKIMIT	KODI GIS	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	DS	SUBJEKTE PERFITUESE
1	53386	67848	RAMIZ	MUSTAFA	SABLI	RIFORCIM	DS4	PO
2	53850	65330	LODOVIK	BARDHOK	LEKGEGAJ	RIFORCIM	DS4	PO
3	14938	65834	AGIM	RASIM	REXHMATI	RIFORCIM	DS4	PO
4	21386	65328	VILDAN	HAKI	QOKU	RIFORCIM	DS4	PO
5	16346	0	XHEVDET	SELIM	NURAJ	RIFORCIM	DS4	PO
6	33908	65945	BEKTASH	HAMDI	PASHNJARI	RIFORCIM	DS4	PO
7	52160	63816	MERQEZ	NAMIK	LEKA	RIFORCIM	DS4	PO



ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	DS	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	KUALIFIKOHET
1	13698	SADIK	SHAHIN	KLLOGJERI	PA STATUS	PRISHJE	PO
2	20523	MELE	HAKI	SHUTINA	DS5	PRISHJE	PO
3	16968	ANDI	ISA	CENGU	DS4	PRISHJE	PO
4	16020	ISA	IDRIZ	CENGU	DS4	PRISHJE	PO
5	38415	ARMAND	HALIT	SHEQI	DS5	PRISHJE	PO
6	18237	PETRIT	HAMID	UKU	DS4	PRISHJE	PO
7	11435	HALIL	IBRAHIM	KOLA	DS4	PRISHJE	PO
8	51350	GANI	SHYQRI	KAZAZI	DS4	RIFORCIM	PO
9	42824	REDION	GËZIM	TABAKU	DS4	PRISHJE	PO
10	42506	SHPETIM	NEXHAT	ARAPI	DS4	PRISHJE	PO
11	4471	SHPETIM	ZAIM	HOXHAJ	DS4	RIFORCIM	PO
12	14230	FERIK	SEFER	HOXHA	PA STATUS	RIFORCIM	PO
13	33873	LUSH	ALI	ZINA	DS4	RIFORCIM	PO
14	5172	SEIT	RAMADAN	KURTI	PA STATUS	PRISHUR ME P.V. IMTV	PO






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 1103 prot.
17

Durrës, më 30.12.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.133 datë 24.12.2020:

Për miratimin e ndryshimit të aneksit 10 të VKB nr.74, datë 24.07.2020 dhe aneksit 4 të VKB nr.77, datë 10.08.2020..

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

